



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 168/1 Prot

Elbasan, më 11.2.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD


Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.1, datë 30.01.2026 “Mbi kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar Bllok-Ndihmën Ekonomike deri në 6% për vitin 2026”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir Bejtja

168



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHDI
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.03.02.2026

Nr. 679 prot

Nr.1 dt.30.01.2026

**Mbi kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar për Bllok Ndhmën
Ekonomike deri në 6% për vitin 2026**

Mbështetur në ligjin 139/2015 për "Vetqeverisjen Vendore", Ligji 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me Ligjin nr 137/2020, bazuar në nenin 21 të ligjin 57 datë 18.07.2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", ku citohet shprehimisht: **Këshilli bashkiak miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror. Me propozim të strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30.01.2026 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:**

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve specifike për familjet që do të përfitojnë Ndhmë Ekonomike me 6% e fondeve të kushtëzuara të Bllok-Ndhmës për vitin 2026.

1.1 Përfshihen në skemën e fondit 6% familjet të cilat janë shpallur me pikë të pamjaftueshme nga sistemi elektronik i Nd.Ek, dhe mbartin problematikat e mëposhtme social-ekonomike.

- Të jenë familje me kryefamiljare Gra dhe në gjendje të dobët ekonomike.
- Të jenë familje që kanë në përbërjen e tyre Persona me Aftësi të kufizuara apo Invalidë Pune
- Të jenë familje ekstremisht të varfëra qoftë edhe kur kanë një automjet të regjistruar por nuk e kanë në përdorim dhe nuk e kanë çregjistruar në Drejtorinë Rajonale të automjeteve për arsye ekonomike.
- Të jenë familje me fëmijë jetim ose në kujdestari të ketyre fëmijëve.
- Të jenë familje me probleme të ndryshme Sociale, dhunë në familje, proces divorci etj.
- Familje që kanë pësuar fatkeqësi natyrore.

2. Për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duhet të jetë kryer paraprakisht vlersimi social ekonomik në familje nga administrator shoqëror sipas formularit tip të verifikimit dhe që ruhet në dosjen e dokumentave të aplikantit pranë njësise vendore dhe që i bashkëngjitet P/Vendimit të ardhur nga Njësiti Administrative.

3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Sherbimeve Sociale.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA



ZV/KRYETARE E KËSHILLIT
Silvana HOXHA

